



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Bujqësi

Nr. 20177 Prot.,

Lezhë, më 21.11.2025

URDHËR

Nr. 631 Datë 21.11.2025

**”PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR VERIFIKIMIN E DËMEVE NË TOKA
BUJQËSORE, BAGËTI, RRUGË RURALE DHE URA, NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE SHËNKOLL, KOLSH DHE ZEJMEN ”**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, nenit 9 pika 1.1 gërma “b” të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, ligjin nr. 24/2017, datë 9.03.2017, “Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit”.

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës për verifikimin e dëmeve në toka bujqësore, bagëti, rrugë rurale dhe ura, në Njësinë Administrative Shënkoll, Zejmen dhe Kolsh, në Bashkinë Lezhë, si pasojë e përmbytjeve të shkaktuara nga reshjet dhe shembja e argjinaturës së Lagunës Vain me datë 19.11.2025, me përbërje si më poshtë:
 - Z. Fatjon Zefi, me detyrë Zëvëndëskryetar i Bashkisë Lezhë – Kryetar,
 - Z. Gjergj Prendi, me detyrë Drejtor i Drejtoria e Emergjencave Civile – Anëtar,
 - Z. Zef Doçi, me detyrë Specialist, në Sektorin e Emergjencave Civile, në Drejtorinë e Emergjencave Civile, – Anëtar,
 - Z. Rubin Sufja, me detyrë Inspektor Terreni për Emergjenat Civile, në Sektorin e Emergjencave Civile, në Drejtorinë e Emergjencave Civile, – Anëtar,
 - Z. Pjetër Lekgjonaj, me detyrë Përgjegjës Sektori në Sektorin e Infrastrukturës, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit – Anëtar,
 - Z. Bardhok Brunga, me detyrë Specialist për Monitorimin e Projekteve në Sektorin e Hartimit të Projekteve, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, – Anëtar,
 - Z. Arben Mesuli, me detyrë Përgjegjës Njësie, Njësia e Rrugëve Rurale, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, – Anëtar,
 - Znj. Alda Prendi, me detyrë Përgjegjës Sektori në Sektorin e Funksioneve Mbështetëse, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve – Anëtar,
 - Z. Lauren Smaçi, me detyrë Specialist Inxhinier në Sektorin e Funksioneve Mbështetëse, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve – Anëtar,